



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2025

1. HYRJE

Komuna e Podujevës gjendet në veri-lindje të Kosovës. Podujeva posedon sipërfaqe prej 633.86 km² (5.8% të sipërfaqes së Republikës së Kosovës). Në aspektin e pozitës gjeografike, komuna e Podujevës shtrihet në luginën e lumit Llap dhe ofron kushte të mira për kultura të ndryshme bujqësore. Ajo kufizohet me pesë komuna tjera të Republikës Kosovës (Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Obiliq dhe Leposaviq). Nisur nga këta faktorë dhe nga kushtet e përshtatshme klimatike, bujqësia përfaqëson një potencial të madh zhvillimi për ekonominë e komunës.

Në Komunën e Podujevës kultivohen kultura të ndryshme bujqësore, kultura lavërtare, pemët e imëta (mjedra, aronia, boronica, dredhëza etj), bimët mjekësore dhe aromatike konsiderohen si kultura strategjike për krijimin e vendeve të reja të punës.

2. SYNIMET PROGRAMORE

Stabiliteti afatgjatë ekonomik dhe shoqëror në radhë të parë varet nga zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë. Ky planprogram ka për qëllim përmirësimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Në kuadër të synimeve kryesore në politikën agrare për vitin 2025 do të jenë:

- **Kalimi nga prodhimtaria në ferma që plotësojnë nevojat e ekonomisë familjare në ferma gjysmë komerciale dhe komerciale;**
- **Zbutja e papunësisë, varfërisë dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës për banorët e zonave rurale.**

3. VIZIONI

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë i harmonizuar sipas standardeve dhe praktikave të BE-së duke respektuar Politikat e Zhvillimit Rural (PZHR) të BE-së, normat ekologjike dhe konkurruese me vendet e rajonit i cili është i mbështetur nga fondet zhvillimore lokale, qeveritare dhe ndërkombëtare.

Podujeva qendër e prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore sidomos pemëve të imëta cilësore për Kosovën, rajonin dhe më gjërë.

4. OBJEKTIVAT E PËRGJITHME

- Edukimi i vazhdueshëm / Përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë,pylltarisë dhe zhvillimit rural;
- Forcimi i zinxhirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut nëbujqësi;
- Mbështetja institucionale në riaktivizimin e fermave, plantacioneve bujqësore dhe kapaciteteve përpunuese ushqimore në komunën e Podujevës;
- Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe rritje të sipërfaqeve punuese me sistem të ujitjes në funksion të rritjes së rendimentit;
- Mbështetja e zhvillimit ekonomik të komunës përmes nxitjes së investimeve në fushat:
 - Pemëtari duke përfshirë pemët e imta (mjedra, dredhëza, manaferra, boronica dhe aronia);
 - Perimtari;
 - Lavërtari;
 - Blegtori;
 - Bletari;
 - Shpeztari dhe
 - Produktetet e veçanta (kërpurdha, bimë medicinale dhe aromatike etj).
- Përfshirja sociale, uljen e varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale.

4.1. OBJEKTIVAT SPECIFIKE 2025:

Sektori pemëtarisë

Përkrahja e fermerëve për ngritjen e pemishteve moderne me pemë të imëta, ku synohet të bëhet përkrahja e:

- 10 fermerëve me fidane të mjedrrës, me nga 1100 euro subvencion në formë të pagesave direkte;
- 15 fermerëve me fidane të feferonave, me nga 700 euro subvencion në formë të pagesave direkte;
- 25 fermerëve me Spëkatëse;
- 20 fermerëve me Gérshërë për krasitje- me bateri.

Sektori i perimtarisë

Ngritje të kapaciteteve të kultivimit të perimeve në ambiente të mbyllura.

Përkrahja e fermerëve me serra të këtyre llojeve:

1. **Serra 50 m²**- 134 fermer;
2. **Serra 500 m²**- 10 fermer dhe
3. **Serra 1000 m²**- 5 fermer.

Sektori i bletarisë

Rritje të kapaciteteve prodhuese për bletarët, ndarje e pajisjeve për bletarë.

Në këtë sektor planifikohet të përkrahen 15 fermer me nga një duplikator.

Sektori i blegtorisë

Rritje të kapaciteteve prodhuese, planifikohet të bëhet ndarja e:

- 162 mëshqerrave barrëse;
- 10 Laktofriz 300 lt dhe
- 5 Mikser për përzierje të ushqimit voluminoz të kafshëve.

Sektori i shpeztarisë

Përkatje e fermerëve në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin e shpeztarisë, përmes shpërndarjes së:

- 4 paisje për vulosjen e vezëve.

Përkatje me mekanizëm bujqësor

Planifikohet të bëhet përkrahja e fermerëve me mekanizëm bujqësor, ku me ç'rast përmes kësaj synohet të arrihet rritja e kapaciteteve prodhuese të kulturave bujqësore përmes përgatitjes më cilësore të tokës.

Ku planifikohet të bëhet përkrahja e fermerëve si në vijim:

- **Freza dhei 1.85 – 40 copë**
- **Pllug 2 rendor - 15 copë**
- **Mbledhëse bari luledielli- 20 copë**
- **Motokultivator me frezë 75 cm- 25 copë**
- **Shpërndarëse plehu 350 l me kardan- 20 copë**
- **Makinë mbjelëse për dy lopë- 27 copë**

Promovimi i sektorit të bujqësisë

Në Komunën e Podujevës planifikohet të bëhet organizimi i aktiviteteve promovuese (pjesëmarrje në panaire, Dita e Mjedrës, Dita e Bletës, etj.).

Mbështetja e përpunuesve lokal

Kjo mbështetje synohet të realizohet përmes krijimit të lidhjeve me investitorët potencial.

5. AKTIVITETE TJERA NË KUADËR TË DREJTORISË:

- Raporti përfundimtarë i korrje-shirjeve përgjedhja e disa fermerëve më të suksesshëm në rendimentet e arritura;
- Këshillime rreth parapërgatitjes së tokës për mbjellje vjeshtore;
- Këshillimet në temat për mbjelljet vjeshtore;
- Kërkesa për shndërrimin apo ndërrimin e destinimit të tokave;
- Bashkëpunimi me organizatat (barnatore bujqësore) që të sigurojnë repromaterial (farë, pleh, mjete dezinfektuese) të cilat ju përshtatën kushteve tona ;
- Mbjelljet vjeshtore dhe përcjellja e tyre;
- Dhënia e këshillimeve të drejtpërdrejta etj;
- Kërkesa për regjistrimin me Numrin Identifikues të Fermerit (NIF);
- Këshilla në pemëtari rreth mbjelljes së llojeve të ndryshme të pemëve;
- Realizimi i mbjelljeve vjeshtore;
- Monitorimi në terren i subvencioneve të ndara gjatë vitit 2024;
- Këshillime me perimtarët që bëjnë kultivimin në serrë.
- Realizimi i planeve vjetore ;

- Zgjedhja e fermerëve më të mirë të vitit tashmë festë tradicionale;
- Bashkëpunimi i mirë me MBPZHR , OJQ, Fakultetin e Bujqësisë etj;
- Pjesëmarrja në seminare dhe takime të ndryshme;
- Punë të përditshme në zyrë dhe punë tjera që janë në interes të Komunës.

Nr.prot 12-320/01-0012879125

Podujevë, 28/02/2025



Drejtori

Liria Hoti Rama